



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE SJIP-A

Nr. 1182/2 Prot

Tiranë, më 12/06/2026

Lënda: Jepet Informacion/Dokument i kërkuar

Znj. S. [REDACTED] K. [REDACTED] A

(Përfaqësuese ligjore e Subjektit Era Film sh.p.k.)

Në cilësinë e kërkuarit kemi depozituar pranë (autoritetit publik), në përputhje me nenin 11, të ligjit 119/2914” Për të drejtën e informimit”, kërkesën për dhënie informacioni me numër rendor 4 datë, 06/08/2026 (sipas regjistrimit të kërkesave).

Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkangjitur gjeni (fotokopje të informacionit që kërkoni):

- Shkresa e Fakultetit të Artit Skenik protokolluar në rektorat me nr. 1182/1 prot., datë 10/06/2026.

Ky informacion do ju dërgohet edhe në Email : e [REDACTED].

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin,

Meris XIBRAKU

DREJTOR

DR.MENAXHIMIT BURIMEVE NJERËZORE SJIP-A





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK  
DEKANATI

Nr. 1182/ Prot.  
17

Tiranë, më 10 / 06 /2026

**Lënda:** Kthim përgjigje shkresës nr. 1182 Prot., datë 08/06/2026

**DREJTORISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE JSIP-A**  
**Z. Meris XHIBRAKU**

Bashkëngjitur po ju dërgojmë materialin e kërkuar mbi procedurat e thirrjes për bashkëpunim me shtëpitë kinematografike për realizimin e filmave të diplomës.

**DEKANI**  
**Prof. Miltiadh KUTALI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK

Nr. 73 Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2026

Lënda: Propozim për ngritje komisioni të vlerësimit shtëpive filmike që konkurojnë për realizimin e punëve të diplomës në programin e studimit Regji Filmi dhe TV, në të dy Ciklet e studimit "Bachelor" dhe "Master i Arteve".

REKTORIT TË UNIVERSITEETIT TË ARTEVE

Prof.Dr. Erald BAKALLI

I nderuar Z. Rektor

Bazuar në "Thirrjen për bashkëpunim me shtëpi kinematografike" publikuar në faqen zyrtare të UARTE më dt 24/03/2026 si dhe "Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës Kombëtare të Kinematografisë dhe Universitetit të Arteve", dt. 14/01/2026, Ju bëj me dije se në përfundim të procesit kanë shprehur interesin 4 (katër) shtëpi filmike të cilat kanë dorëzuar edhe dosjet përkatëse pranë Fakultetit të Artit Skenik.

Për sa më lart dhe për mbylljen e procesit përzgjedhës, propozoj:

- Ngritjen e Komisionit Vlerësues të Dosjeve me përbërje: 4 (katër) përfaqësues të studentëve:

(2 (dy) nga cikli i studimeve "Bachelor" dhe 2 (dy) nga cikli i studimeve "Master i Arteve";

2 (dy) pedagogë përfaqësues të programit të studimit Regji Filmi dhe TV;

1 (një) përfaqësues nga QKK.

Departamenti Regji, Regji Filmi dhe TV, propozon si përfaqësues të tij pedagogët Prof. Besnik BISHA dhe As. Lek. Elvis LULE.


Përfaqësues të studentëve do të jenë:

Në Ciklin e Parë të studimeve "Bachelor": [REDACTED]

Në Ciklin e Dytë të studimeve "Master i Arteve": [REDACTED]

Ju përcjell këtë propozim së bashku me kërkesën për komunikim me QKK për të marrë emrin e përfaqësuesit të tyre në këtë komision.

Duke Ju uruar punë të Mbarë,

DEKARATIM  
Prof. Miltiadi KUTATI  




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK  
NJËSIA BAZË REGJI DHE REGJI FILMI & TELEVIZIONI

Nr. Uk/2026 P.fot.

Dt. 30/03/2026

Lënda: Propozim për ngritje komisioni të vlerësimit shtëpive filmike që konkurojnë për realizimin e punëve të diplomës në programin Bachelor dhe Master RFTV.

I nderuar Z. Dekan.

Bazuar në "Thirrjen për bashkëpunim me shtëpi kinematografike" publikuar në faqen zyrtare të UART, më dt 24/03/2026 si dhe "Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës Kombëtare të Kinematografisë dhe Universitetit të Arteve", dt. 14/01/2026, Ju bëj me dije se në përfundim të procesit kanë shprehur interesin 4 (katër) shtëpi filmike të cilat kanë dorëzuar edhe dosjet përkatëse pranë Fakultetit të Artit Skenik.

Për sa më lart dhe për mbylljen e procesit përzgjedhës, propozoj:

Ngritjen e Komisionit Vlerësues të Dosjeve me përbërje: 4 (katër) përfaqësues të studentëve (2 (dy) nga Bachelor dhe 2 (dy) nga Master); 2 (dy) pedagogë përfaqësues të RRFTV; 1 (një) përfaqësues nga QKK.

RRFTV propozon si përfaqësues të tij pedagogët Prof. Besnik Bisha dhe As. Lek. Elvis Lule.

Përfaqësues të studentëve do të jenë:


Bachelor: [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED]

Master: [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED]

Lutem përcillini Rektorit të Uart këtë propozim së bashku me kërkesën për komunikim me QKK për të marrë emrin e përfaqësuesit të tyre në këtë komision.

Duke Ju uruar punë të Mbarë,

Përgjegjësi i Njesis Bazë

  
Prof. As. Alert ÇELOALIAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK  
NJËSIA BAZË REGJI DHE REGJI FILMI & TELEVIZIONI

Nr. 23/Prot.

Dt. 10/04/2026

Lënda: Mbi komisionin e vlerësimit shtëpive filmike që konkurrojnë për realizimin e punëve të diplomës në programin Bachelor dhe Master RFTV.

I nderuar Z. Dekan.

Bazuar në "Thirrjen për bashkëpunim me shtëpi kinematografike" publikuar në faqen zyrtare të UART më dt 24/03/2026, "Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës Kombëtare të Kinematografisë dhe Universitetit të Arteve", dt. 14/01/2026, si dhe bazuar në shkresën e RRFTV dt. 30/03/2026 "Propozim për ngritje komisioni të vlerësimit shtëpive filmike që konkurrojnë për realizimin e punëve të diplomës në programin Bachelor dhe Master RFTV", Ju bëj me dije se pas komunikimeve verbale me përfaqësuesin e QKK, ngarkuar për të ndjekur këtë proces nga ana e tyre, jemi njoftuar se përfaqësuesi i QKK nuk do të jetë pjesë e komisionit vlerësues për shkak të konfliktit të interesit. Gjithashtu është kërkuar që vendi i lirë në këtë komision të zëvendësohet me një tjetër student. Po ashtu, edhe prezenca e përfaqësuesve nga ana e trupës pedagogjike, për shkak të natyrës së punës dhe njohjes me shtëpitë filmike në konkurrim, është parë si çënim i procesit që mund të interpretohet në vazhdimësi si konflikt interesi dhe për këtë arsye nuk do të jenë pjesë e vlerësimit për të shmangur pengimin e procesit në vazhdimësi.

Duke qenë se sot është data e fundit e dorëzimit nga ana jonë e aplikimit në QKK për financimin e të dy cikleve (diplomat Bachelor dhe Master), në mungesë të kohës dhe pas komunikimit me të dy pedagogët e kurseve, Prof. Besnik Bisha dhe Dr. Elis Mataj, RRFTV vendosi zëvendësimin e anëtarit të QKK me një student të Ciklit të Dytë Master dhe kryerjen e vlerësimit të shtëpive filmike nga një komision studentor i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë.

Në përfundim, përbërja e komisionit vlerësues do të jetë si më poshtë:

Bachelor: [REDACTED]

Master: [REDACTED]

Duke Ju uruar punë të Mbarë,

Përgjegjësi i Njesis Bazë

Prof. As. Alert ÇELOALIAJ



Adresa: Bll. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri, Tel: +355 42 247 598, [www.uart.edu.al](http://www.uart.edu.al)

## PROCESVERBAL

Për votimin nga kryesia për përzgjedhjen e kompanisë fituese për prodhimin e filmave të diplomës

Sot, më datë 10 / 04/ 2026, në ambientet e Universitetit të Arteve, u zhvillua mbledhja e kryesisë së studentëve, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

- [REDACTED]
- [REDACTED]
- [REDACTED]
- [REDACTED]
- [REDACTED]

Qëllimi i mbledhjes:

Votimi për përzgjedhjen e kompanisë fituese për prodhimin e filmave të diplomës, në kuadër të bashkëpunimit me QKK.

Kompanitë pjesëmarrëse:

- Era Film
- MMS NOSITI shpk
- Nilor Film
- Black Box Film

Kriteret e vlerësimit:

Kryesia shqyrtoi kompanitë pjesëmarrëse duke u bazuar në këto kriterë:

- Eksperienca në prodhim filmash
- Kapacitetet teknike dhe profesionale
- Disponibiliteti për realizimin e projekteve



Procesi i votimit:

Pas diskutimeve dhe vlerësimit të secilës kompani, u zhvillua votimi i hapur.

Rezultati i votimit:

Në përfundim të votimit, kompania fituese u shpall:

MMS NOSITI

(me 5 vota)


Vendimi:

Kryesia vendosi që kompania e sipërpërmendur të propozohet si fituese për prodhimin e filmave të diplomës dhe të vijojë procedurat për bashkëpunim me QKK.

Mbyllja e mbledhjes:

Mbledhja u mbyll në orën 11:30 pa kundërshtime nga anëtarët e kryesisë.

Anëtarët e Kryesisë



*Ministoket propozimi i  
departamentit*  
*26.2.2026*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK  
DEKANI

Nr. 441 prot.

Tiranë, më 25/2/2026

26/02/2026  
Lënda: Përcjellje e propozimit për thirrjen e hapur dhe kriteret përzgjedhëse të shtëpive filmike për realizimin e filmave diplomë të studentëve të Viti të 3të, Cikli i Parë Bachelor dhe atij të Vitit të 2të, Cikli i Dytë Master.

REKTORIT TE UNIVERSITETIT TE ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Zoti Rektor!

Në vijimësi të komunikimeve tona, nëpërmjet kësaj shkrese po ju përcjell propozimin për thirrjen e hapur dhe kriteret përzgjedhëse të shtëpive filmike për realizimin e filmave diplomë të studentëve të Viti të 3të, Cikli i Parë Bachelor dhe atij të Vitit të 2të, Cikli i Dytë Master në Programet e Studimit Regji Filmi dhe Televizioni hartuar nga Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni.

Bashkangjitur kenë edhe prozimin e Departamentit.

Ju faleminderit.

DEKANI

*[Signature]*  
Prof. Miltiadh KUTALI

FAKULTETI I ARTIT SKENIK





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK  
DEKANI

Nr. 52 prot.

Tiranë, më 25/2/2026

**Lënda:** Përcjellje e propozimit për thirrjen e hapur dhe kriteret përzgjedhëse të shtëpive filmike për realizmin e filmave diplomë të studentëve të Viti të 3të, Cikli i Parë Bachelor dhe atij të Vitit të 2të, Cikli i Dytë Master.

REKTORIT TE UNIVERSITETIT TE ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Zoti Rektor!

Në vijimësi të komunikimeve tona, nëpërmjet kësaj shkrese po ju përcjell propozimin për thirrjen e hapur dhe kriteret përzgjedhëse të shtëpive filmike për realizmin e filmave diplomë të studentëve të Viti të 3të, Cikli i Parë Bachelor dhe atij të Vitit të 2të, Cikli i Dytë Master në Programet e Studimit Regji Filmi dhe Televizioni hartuar nga Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni.

Bashkangjitur keni edhe prozimin e Departamentit.

Ju faleminderit.

DEKANI

Prof. Miltiadh KUTALI



FAKULTETI I ARTIT SKENIK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK  
NJËSIA BAZË REGJI DHE REGJI FILMI & TELEVIZIONI

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Dt. 24/02/2026

Lënda: Propozim për thirrjen e hapur dhe kriteret përzgjedhëse të shtëpive filmike për realizmin e filmave diplomë të studentëve të Viti të 3të, Cikli i Parë Bachelor dhe atij të Vitit të 2të, Cikli i Dytë Master.

Dekanit FAS, Prof. Miltiadh KUTALI


I nderuar Z. Dekan,

Lutem gjeni bashkëlidhur propozimin për thirrjen e hapur dhe kriteret përzgjedhëse të shtëpive filmike për realizmin e filmave diplomë të studentëve të Viti të 3të, Cikli i Parë Bachelor dhe atij të Vitit të 2të, Cikli i Dytë Master në Programet e Studimit Regji Filmi dhe Televizioni hartuar nga Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni.

Lutemi ia përcillni këtë material Rektorit të UART, Prof. Dr. Erald BAKALLI me qëllim hapjen udhë të procedurave të mëtejshme.

Duke Ju uruar punë të mbarë,

Përgjegjësi i Njesisë Bazë



Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK

Nr. Prot \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

**PROPOZIM PËR THIRRJE TË HAPUR PËR PËRZGJEDHJEN E SHTËPIVE  
KINEMATOGRAFIKE QË DO TË REALIZOJNË PROJEKTET FILMIKE NË  
KUADËR TË "PAKTIT PËR UNIVERSITETIN"**

Universiteti i Arteve, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, në datën 14.01.2026, kanë nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit në mbështetje të programit Kombëtar "Pakti Për Universitetin". Ndër të tjera, në Memorandumin e Bashkëpunimit palët kanë marrë angazhimin për të vazhduar mbështetjen financiare të projekteve filmike të diplomës së studentëve të vitit të 3-të Bachelor, në Fakultetin e Artit Skenik, Programi i Studimit "Regji Filmi dhe Televizioni", për vitin akademik 2025-2026.

Në përmbushje të angazhimit të sipërpërmendur, shpallim thirrjen publike për përzgjedhjen e shtëpive kinematografike që do të marrin përsipër të realizojnë këto projekte. Shtëpitë filmike do të vlerësohen mbi dosjet e paraqitura në QKK.

**Kriteret përzgjedhëse janë si vijon:**

- Shtëpia kinematografike do të angazhohet për realizimin e të gjitha projekteve filmike brenda kësaj thirrjeje publike.
- Shtëpia kinematografike duhet të ketë eksperiencë në realizimin e filmave artistikë me metrazh të gjatë dhe të shkurtër.
- Shtëpia kinematografike duhet të ofrojë/sigurojë shërbimet e një trupe profesionale në çdo sektor të punës, në shërbim të projekteve.
- Shtëpia kinematografike duhet të ketë aftësinë e promovimit të filmave jo vetëm në tregun vendas, por edhe në festivale apo evente filmike të të njëjtit nivel apo më mirë.
- Nëse Shtëpia kinematografike në përfundim të realizimit të projekteve nuk arrin të plotësojë këtë kriter, UART rezervon të drejtën t'i kërkojë QKK përjashtimin e saj nga pjesëmarrja në realizimin e projekteve filmike në vitet pasardhëse.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Shtëpia kinematografike duhet të angazhojë aktorë profesionistë (brenda buxhetit të përcaktuar) me dy qëllime: të jenë një mundësi për regjisorët e rinj për t'u përballur me aktorët dhe për të realizuar figura sa më cilësore, por gjithashtu edhe për të pasur figura publike që mundësojnë një promovim të suksesshëm të këtyre filmave.
- Shtëpia kinematografike duhet të plotësojë kërkesat për realizimin e skenave (dekoreve) dhe kostumeve sipas përcaktimit në skenarët e miratuara nga UART apo t'i ofrojë/sigurojë këto skena dhe kostume brenda buxhetit të përcaktuar.
- Shtëpia kinematografike duhet të garantojë post-produksionin e filmave në kohë dhe me cilësi, duke respektuar kërkesat e studentit regjisor dhe pedagogut të tij.
- Duke qenë se kinematografia është një industri e cila evoluon me ritme të shpejta nga ana teknike, duhet që studentëve t'u ofrohet mundësia të njihen, përdorin dhe xhirojnë me mjete teknike bashkëkohore, të cilat shtëpia kinematografike do t'i vërë në dispozicion të studentëve brenda buxhetit të përcaktuar.
- Shtëpia kinematografike duhet të garantojë që aktorët e kontraktuar të jenë pjesë e promovimeve (në rast se do të ketë) realizime, brenda dhe jashtë Shqipërisë, kur kjo kërkohet nga FAS.
- Shtëpia kinematografike duhet të sigurojë ruajtjen në arkivën e saj të projekteve të dala nga ky bashkëpunim pavarësisht kopjeve që duhet të dorëzojë në UART dhe QKK. Punët e realizuara në kuadër të këtij bashkëpunimi janë vepra të krijuara si pjesë e provimeve ose në përmbushje të detyrimeve për diplomim. Shtëpia kinematografike ka detyrimin të ofrojë asistencë teknike gjatë shfaqjes së filmave, duke garantuar që materiali audioviziv të jetë në formatin e duhur dhe të mos paraqesë probleme teknike gjatë projeksionit
- Shtëpia kinematografike nuk mund të bëjë asnjë ndryshim në skenarët letrarë, apo tekniko-regjisorialë të dorëzuar pa miratimin e pedagogut udhëheqës të projekteve dhe Departamentit Regji, Regji Filmi dhe Televizioni.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Shtëpia kinematografike duhet të deklarojë me shkrim se do të pranojë pa të drejtë ankimi rezultatet e shpallura nga QKK dhe UART në mbyllje të procesit për zgjedhës për këto projekte.
- Shtëpia kinematografike duhet të plotësojë të gjitha kërkesat ligjore dhe financiare që lindin gjatë bashkëpunimit me QKK dhe UART.

Dokumentacioni që duhet të paraqitet do të jete conform kërkesave dhe kriterëve të paraqitura QKK.

Përgjegjës i njësisë bazë

Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

